



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria Për Mbrojtje dhe Shpëtim

Odelenje za Zastitu i Spasavanje

Department for Protection and Rescue



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC

Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. I prot. 121 Më 14.01 2020
Br. prot. Dt. 14.01 2020
RAHOVEC - ORAHOVAC

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2019

Gjatë vitit 2019 në DMSH janë zhvilluar aktivitete si më poshtë:

Gjashtë mujori i parë: janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor

- Zhvillimi i aktiviteteve propagandistike në edukimin dhe vetëdijimin e popullatës për zjarret malore- fushore, dalja në terren, ku është bërë identifikimi i lokacioneve të cilat mund të jenë të rrezikuara nga vërshimet në komunën e Rahovecit (Konform Planit të Punës së Drejtorisë);
- Ka përfunduar ndërtimi i garazhës prapa objektit aktual të zjarrfikësve. Ky aneks objekt është ndërtuar me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës së nevojshme për zjarrfikësit dhe që ata të jenë sa më të kompletuar në çdo aspekt (Konform Planit të punës së drejtorisë);
- Inspektimi i rregullt i objekteve publike, private dhe shëndetësore për verifikimin e gjendjes së aparateve për shuarjen e zjarreve (Konform Planit të punës së drejtorisë);
- Jemi angazhuar në menaxhimin e situatës që është krijuar në komunën tonë pas reshjeve intensive të borës, së bashku me kompanitë e kontraktuara nga Komuna kemi qenë tërë kohën në terren, në çdo vendbanim të gjitha rrugët primare dhe sekondare janë pastruar me kohë dhe nuk është krijuar ndonjë problem në qarkullimin e lirë të automjeteve dhe këmbësorëve.
- Angazhim të rregullt në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;
- Në muajin maj me qëllim të ngritjes së gatishmërisë dhe zvogëlimit të rrezikut nga tërmetet në shkollë, Agjencia e Menaxhimit Emergjent, në bashkëpunim me drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe drejtorinë e Arsimit në Rahovec, ka organizuar një stërvitje me simulatorë (automjetet ku simulohet tërmeti), me nxënësit e komunës sonë. Qëllimi i stërvitjes ishte senzibilizmi, njohja dhe përgatitja e nxënësve se si duhet të sillen dhe të mbrohen në rastet e tërmeteve, automjeti me simulator për tërmete është në kuadër të bashkëpunimit të AME-së me AFAD-in Turk;
- Është bërë servisi i të gjitha aparateve për shuarjen e zjarreve (Konform Planit të punës së drejtorisë).
- Në fillim të muajit qershor kemi pranuar donacion një kamion modern të zjarrfikjes që është donacion nga Qeveria Japoneze për Njësinë e Zjarrfikësve në Rahovec;
- Poashtu, në muajin qershor ka arritur edhe donacioni i radhës, kësaj here nga zjarrfikësit e Francës, donacioni është një kamion dhe uniforma për zjarrfikësit;
- Kemi blerë uniforma dhe mjete të punës për stafin e zjarrfikësve (Konform Planit të punës së drejtorisë).

Gjashtë mujori i dytë: korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor

- Është mbajtur ushtrimi fushor "UJKU 02/2019" në bashkëpunim me FSK-së dhe njësitë emergjente të komunës sonë, ushtrimi ka zgjatur 3 ditë duke filluar nga 25.06.2019 deri më 27.06.2019. Ushtrimi ka përfunduar mirë, e nga ky ushtrim njësitë emergjente të komunës sonë kanë fituar përvojë të re për intervenim sa më të mirë në raste reale kur ndodhin.
- Angazhim për festën e vjeljes së rrushit "Hardhfest" 2019, angazhim të rregullt në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;
- Si drejtor, poashtu kam qenë i angazhuar në menaxhimin e kontratës për mirëmbajtje të ndriçimit publik, gjatë këtij viti kemi arritur të intervenojmë në çdo vendbanim të komunës ku ka pasur probleme me ndriçim publik;

- Me vendim të Kryetarit të Komunës jam caktuar koordinator për koordinimin e dërgimit të ndihmave në Shqipëri të cilat janë grumbulluar nga qytetarët tanë, ndihmat në mënyrë të organizuar janë dërguar në vendet e prekura nga tërmeti.

Raporti vjetor i intervenimeve për vitin 2019 i Njesisë për Zjarrfikje dhe Shpëtim-Rahovec

Viti 2019	Zjarre në objekte private						Zjarre në objekte eko.				Zjarre në pajisje			Zjarre në sipërfaqe					Zjarr në Auto	Gjith.		
Muaji																						
	Banasa / shtëpi	Objektëndimse	Plevica - Shtalla	Objekte kolektive	Oxhaqe	Mbeturina	Zjarre të rrejtshme	Publike	Objekte Biznesi	Objekte Industriale	ushqim bagtije	Pajisje elektrike	Pajisjetshpërndarëse	Gjeneratora	Sherbime	Mali	Barri i that	Sipërfaqe bujqësore	Vershime	Intervenime Teknike	Automjete Motorike	
Janar	1				1	1											1		1			5
Shkurt		2				1							1		4	1	12					21
Mars	2		1		1	2	1	2	2			1				26	28				2	68
Prill			1			1	1									3	4		1			11
Maj		1				2			1										2	5		11
Qershor	1					1									3		1		3	3		12
Korrik	1					4		1									6		1	5	2	20
Gusht			2			2									1	3	10					18
Shtator						2				3						2	5		1			13
Tetor	1					2					2	1					1			2		9
Nëntor																				1		1
Dhjetor		1				1						1								1	2	6
Total	6	4	4	0	2	19	2	3	3	3	2	3	1	0	8	35	68	0	9	17	6	195

13.01.2020

Rahovec

Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim

Hasan Përboqi

